



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Prishtinë, 30 Dhjetor 2024

BULETINI
INFORMATV

Tetor - Dhjetor 2024



www.fefs.uni-pr.edu

FJALA E DEKANIT

Të dashur studentë,
Të nderuar kolegë,
Të respektuar përfaqësues të Universitetit të Prishtinës dhe partnerë të nderuar,

Sot jemi këtu për të reflektuar mbi një periudhë të jashtëzakonshme të arritjeve dhe përpjekjeve të përbashkëta që kanë shënuar rrugëtimin tonë si fakultet. Në dritën e buletinit tonë informativ, dua të theksoj se këto arritje nuk janë vetëm dëshmi e përkushtimit tonë ndaj edukimit dhe sportit, por edhe një udhërrëfyes për të ardhmen tonë të ndritur.

Një falënderim i veçantë shkon për ju, të dashur studentë, për pjesëmarrjen aktive në aktivitetet tona, si në kurset e administrimit sportiv, hulumtimet shkencore, dhe projektet ndërkombëtare si "S2ABC", "Sport as Value", "SHAPE" duke shkëlqyer në çdo aktivitet.

Po ashtu, me krenari theksoj sukseset tuaja të jashtëzakonshme në fitimin e trofeve në kompeticione ndërkombëtare, duke shkëlqyer në arenën ndërkombëtare me vendet e para ndër vite. Për këtë, ju jemi përzemërsisht mirënjohës, sepse suksesi juaj na përfaqëson denjësisht dhe fuqizon imazhin e fakultetit tonë. Ju jeni frymëzimi ynë dhe arsyeja pse vazhdojmë të shtyjmë kufijtë e mundësive.

Për kolegët e mi, dua të nënvizoj rëndësinë e punës suaj të palodhshme. Ju uroj për mbarëvajtjen e procesit mësimor, përkushtimin dhe përditësimin e ligjëratave, si dhe për angazhimin tuaj në mentorime, komisione dhe hartimin e rregulloreve dhe dokumenteve të tjera relevante që kanë qenë dhe do të mbeten në dobi të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit. Po ashtu, ju përgëzoj për punën tuaj të shkëlqyer në fushën e hulumtimit shkencor, ku si dëshmi e përpjekjeve tuaja të palodhshme shihet rritja e dukshme e numrit të publikimeve në revista prestigjioze. Ky është një tregues i qartë i përkushtimit tuaj ndaj avancimit të dijes dhe imazhit shkencor të fakultetit tonë.

Një falënderim i tjetër shkon gjithashtu për Universitetin e Prishtinës dhe partnerët tanë institucionalë, që kanë ofruar mbështetje të vazhdueshme në projektet dhe iniciativat tona. Ky bashkëpunim strategjik ka luajtur një rol kyç në realizimin e objektivave tona dhe në zgjerimin e mundësive për studentët dhe stafin.

Ndërsa ecim përpara, më lejoni të ju inkurajoj të vazhdoni me të njëjtën energji dhe dedikim. Së bashku, ne mund të ndërtojmë një të ardhme ku Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit jo vetëm që shërben si qendër e shkëlqimit akademik dhe profesional, por edhe si një simbol i unitetit, inovacionit dhe përkushtimit ndaj vlerave sportive në vendin tonë!

Ju falënderoj të gjithëve për angazhimin dhe mbështetjen tuaj. Së bashku, le të vazhdojmë të shkruajmë kapituj të rinj të suksesit!

Urime dhe gëzuar vitin e ri 2025.



DEKAN
PROF.ASST. FLORIAN MIFTARI

MALSOR GJONBALAJ DHE FATON TISHUKAJ JANË ZGJEDHUR PRODEKAN PËR MËSIM DHE SHKENCË

Dekani i ri i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, Prof. Asst. Florian Miftari, ka formuar ekipin e tij të prodekanëve, duke përzgjedhur personalitete të spikatura akademike që do të kontribuojnë në drejtimin dhe avancimin e fakultetit drejt standardeve më të larta.

Në pozicionin e Prodekanit për Mësim dhe Çështje të Studentëve është emëruar Prof. Asst. Malsor Gjonbalaj, një figurë me përvojë të pasur në sport dhe edukimin e studentëve. Me ekspertizën e tij të njohur në fushën e futbollit dhe edukimit fizik, Prof. Gjonbalaj do të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e përvojës akademike të studentëve dhe zhvillimin e programeve mësimore.

Ndërkohë, në pozicionin e Prodekanit për Shkencë dhe Marrëdhënie me Jashtë, është emëruar Prof. Asst. Faton Tishukaj. Me një karrierë të shquar ndërkombëtare në kërkimin shkencor dhe një angazhim të fortë për ndërtimin e lidhjeve ndërkombëtare, Prof. Tishukaj do të jetë një shtyllë e rëndësishme në avancimin e projekteve kërkimore të fakultetit dhe krijimin e partneriteteve të reja me institucione të huaja.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, me këtë ekip të ri drejtues, mbetet i përkushtuar për arritjen e standardeve të larta akademike dhe për të avancuar ndërkombëtarizimin, duke i ofruar studentëve mundësi të reja për zhvillim personal dhe profesional.

I urojmë suksese prodekanëve të sapozgjedhur në misionin e tyre dhe besojmë se nën drejtimin e këtij ekipi të përkushtuar, Fakulteti do të arrijë nivele të reja të shkëlqimit. Lexo më shumë [këtu](#).

Janë konsistuar organet e FEFS


Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit ,ka zgjedhur organet,përkatësisht ka emëruar Komisionet për sistematizim sipas Statutit të UP-së dhe rregulloreve për organizimim dhe funksionalizim brenda njesisë akademike:

- Kordinatori për zhvillim akademik
- Komisioni për studime
- Komisioni për mbrojtjen e projekteve Mastër
- Komisioni i Etikës në Hulumtim
- Janë zgjedhur mentorët e viteve
- Janë zgjedhur organet drejtuese të Institutit



FUNKSIONALIZIMI I INSTITUTI TË SHKENCAVE TË SPORTIT, JANË ZGJEDHUR DREJTORI DHE SEKRETARI I INSTITUTIT NË FEFS

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit është në procesin e funksionalizimit të Institutit të Sportit, një hap i rëndësishëm drejt avancimit të hulumtimeve shkencore dhe zhvillimit profesional në fushën e sportit. Ky institut do të shërbejë si qendër e ekselencës për kërkimin shkencor, inovacionin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, duke u ofruar studentëve dhe stafit mundësi të reja për të kontribuar në përparimin e sportit dhe shëndetit.



Për ta bërë të mundur funksionalizimin e Institutit të Sportit, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit ka emëruar drejtuesit e tij. Si drejtor i institutit është zgjedhur Prof. Asst. Bahri Gjinovci, ndërsa për sekretar është emëruar Prof. Asst. Ilir Gllareva nën udhëheqjen e Prodekanit për shkencë Prof. Asst. Faton Tishukaj.

Ky ekip drejtues pritet të luajë një rol kyç në zhvillimin dhe menaxhimin e suksesshëm të institutit.

Lexo më shumë [këtu](#).



JANË HARTUAR RREGULLORE TË BRENDSHME NË FEFS

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit ka hartuar tri rregullore të brendshme:

- Rregulloren për karrierë të dyfisht
- Rregulloren për Disiplinë dhe Siguri në kursin e Skijimit,
- Rregulloren për Disiplinë dhe Siguri në Fushim Malor dhe Bregdetar

1. Qëllimi i Rregullores për karrierë të dyfisht

Kjo rregullore shërben për të krijuar një kornizë të qartë dhe mbështetëse për sportistët, duke u mundësuar atyre të balancojnë në mënyrë efektive angazhimet sportive me edukimin dhe zhvillimin profesional. Kjo rregullore synon:

- Promovimin e arsimit dhe trajnimit profesional, duke siguruar që sportistët të kenë mundësi të zhvillojnë aftësi për një karrierë përtej sportit aktiv.
- Mbështetjen gjatë karrierës sportive, duke ofruar fleksibilitet dhe mbështetje logjistike për të përmbushur kërkesat akademike dhe profesionale.
- Lehtësimin e tranzicionit pas përfundimit të karrierës sportive, duke ndihmuar sportistët të integrohen në tregun e punës ose fusha të tjera të interesit.

Kjo rregullore përfaqëson një angazhim të rëndësishëm për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme për sportistët, duke i fuqizuar ata të arrijnë sukses si në sport ashtu edhe në fusha të tjera të jetës.

2. Qëllimi i Rregullores për Disiplinë dhe Siguri në kursin e Skijimit

Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë mbarëvajtjen e kursit të skijimit dhe të minimizojë rreziqet gjatë qëndrimit në bjeshkë. Ajo gjithashtu përcakton standardet e larta të sjelljes dhe disiplinës që priten nga studentët gjatë gjithë periudhës së kursit.

3. Qëllimi i Rregullores për Disiplinë dhe Siguri në Fushim Malor dhe Bregdetar

Kjo rregullore ka për qëllim të sigurojë mbarëvajtjen e aktiviteteve në fushim malor dhe bregdetar, duke minimizuar rreziqet dhe duke garantuar një sjellje të përshtatshme të studentëve gjatë këtyre aktiviteteve. Ajo përcakton standardet e larta të disiplinës dhe sigurisë që priten nga studentët në të dy ambientet.

FEFS ANËTARE E RE NË ORGANIZATAT NDËRKOMBETARE: S2ABC, ENGSO, ENSHE

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit – Lider në Ndërkombëtarizim dhe Bashkëpunime Globale Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS) në Universitetin e Prishtinës vazhdon të ndërtojë një rol të fuqishëm ndërkombëtar, duke u bërë anëtar i disa prej organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e sportit dhe edukimit. Në vitin e fundit, FEFS ka arritur të anëtarësohet në organizata prestigjioze si S2ABC, ENGSO (European Non-Governmental Sports Organisation) dhe ENSE (European Network of Sport Education), duke përforcuar pozicionin e tij si një institucion udhëheqës në rajon dhe më gjerë.

Anëtarësimet Strategjike – Bazë për Bashkëpunime të Reja

- S2ABC: Pjesëmarrja në këtë rrjet i ofron Fakultetit mundësi të përfshihet në projekte inovative dhe të zhvillojë qasje të reja në sport si një vlerë për komunitetet.
- ENGSO: Anëtarësimi në këtë organizatë prestigjioze evropiane fuqizon angazhimin e Fakultetit në promovimin e sportit për zhvillim dhe përfshirjen sociale, duke hapur dyer për projekte bashkëpunimi dhe shkëmbime akademike ndërkombëtare.
- ENSE: Si pjesë e këtij rrjeti, FEFS përforcon kapacitetet akademike dhe hulumtuese duke ofruar qasje në standardet dhe praktikat më të mira të arsimit të lartë sportiv në Evropë.

Me këto hapa të rëndësishëm, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit jo vetëm që afirmon vlerat dhe potencialin e tij, por gjithashtu kontribuon në ngritjen e profilit të Universitetit të Prishtinës si një qendër e njohur ndërkombëtarisht për shkencat e sportit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.



STUDENTET E FEFS KANË SHKELQYER NË KURSIN S2ABC

Pas anëtarimit në S2ABC ka filluar kursi i Administrimit në Sport për studentët e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit.

Si pjesë e programit Erasmus Plus Capacity Building, kursi ka sjellë një mundësi të jashtëzakonshme për studentët tanë për të zgjeruar horizontet e tyre në fushën e administrimit të sportit.

Në përputhje me parimet e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe të këmbënguljes sonë për të përmirësuar cilësinë e arsimit, kjo iniciativë është një hap i rëndësishëm drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta për zhvillimin profesional të studentëve tanë. Duke u trajnuar në menaxhimin e sportit, ata fitojnë njohuri të reja, aftësi praktike dhe përvojë që do t'u shërbejnë për të ndërtuar karrierën e tyre në fushën e sportit.

Ne jemi të përkushtuar për të mbështetur këtë rrugëtim të studentëve tanë dhe për të siguruar një mjedis të frytshëm për zhvillimin e tyre profesional. Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë pedagogët, stafin administrativ dhe përfaqësuesit e programit Erasmus Plus për përkushtimin dhe mbështetjen e tyre të palodhur në realizimin e këtij projekti.

Ne jemi të sigurt se ky kurs do të jetë një udhëtim emocionues dhe frytdhënës për të gjithë pjesëmarrësit, dhe ne presim me padurim të shohim suksesin dhe arritjet e tyre në të ardhmen.



FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT (FEFS) KA MARRË PJESË NË DY KONFERENCA TË RËNDËSISHME NDËRKOMBËTARE, DUKE THEKSUAR PËRKUSHTIMIN E TIJ PËR ZHVILLIMIN E SPORTIT DHE EDUKIMIN NË NIVEL RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Në konferencën "EAS 2024 Annual Conference" të mbajtur në Akademinë e Edukimit Fizik AWF Katowice, Poloni, me temë "Dual career at sports and university - innovative bridges between sport and education," Prodekani për Shkencë dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Prof. Asst. Faton Tishukaj, prezantoi me sukses gjetjet e projektit "Sport as Value." Ky projekt ka për qëllim avancimin e sportit bazë dhe aplikimin e praktikave të mira në Ballkanin Perëndimor dhe BE, ku Fakulteti ka luajtur një rol udhëheqës.


Gjithashtu, në konferencën "Scoring Development: Regional Cooperation and Youth Empowerment through Sport" të organizuar nga GIZ dhe RYCO në Shkup, Fakulteti u vlerësua për përfshirjen e lëndës "Sporti për Zhvillim" në planprogramin bachelor. Kjo lëndë synon të fuqizojë të rinjtë përmes sportit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Gjatë konferencës u theksua nevoja për organizimin e një konference rajonale ndëruniversitare për promovimin e sportit si mjet për zhvillim dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Përmes këtyre pjesëmarrjeve, FEFS konfirmon angazhimin e tij për të avancuar sportin dhe edukimin, duke kontribuar në fuqizimin e të rinjve dhe zhvillimin social në rajon dhe më gjerë.



BRENDINI, UNIFORMIMI DHE SINJALIZIMI I RI NË FEFS

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, ka bërë brendimin, uniformimin dhe sinjalizimin e ri. Ky ndryshim do i ndihmojë studentët të kenë qasje dhe orientim më të lehtë, në sallat e mësimit, sallat e ushtrimeve, në zyret e shërbimit të studentëve, kabinetet e stafit akademik për konsultime, bibliotekë dhe hapësira tjera të rëndësishme të dedikuara për studentët.



JANË PROMOVUAR NË VAZHDIMSI AKTIVITETET E STUDENTËVE NË PLATFORMA SOCIALE

Një ditë e zakonshme në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit.

Studentët tanë janë gjithmonë të angazhuar dhe të përkushtuar, duke ndjekur ligjëratat dhe aktivitetet praktike me pasion dhe përkushtim.

Suksesi i tyre është prioriteti i yni!



ËSHTË MBAJTUR MË SUKSES AKTIVITETI ME SHKOLLAT NË KUADËR TË PROJEKTIT SHAPE-JAVA SPORTIVE NËN UDHËHEQJEN E PRODEKANIT PROF.ASST MALSOR GJONBALAJ

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit (FEFS) në bashkëpunim me Shkollën Filllore të Mesme e Ulët, "Faik Konica" ka realizuar aktivitete sportive me nxënësit e klasës së 4-të të kësaj Shkolle.

Aktivitetet janë realizuar sot në kuadër të javës, "West Balkan Week of Sport" që është duke u realizuar si pjesë e projektit SHAPE në të cilin projekt, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" FEFS-së është partner. Aktivitetet e kësaj jave kanë për qëllim promovimin e edukimit fizik dhe sportit dhe vlerava të mirëfillta sportive në shërbim të vetëdijësimit të qytetarëve të të gjitha moshave për rëndësinë e sportit për shëndetin dhe mirëqenien e tyre.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit (FEFS) do të vazhdojë të jetë një promotor aktiv i edukimit fizik dhe sportit përmes aktiviteteve të ndryshme bashkëpunuese me institucione arsimore dhe komunitetin e gjerë. Në të ardhmen, FEFS synon të zgjerojë këto nisma me qëllim që të forcojë kulturën sportive dhe të frymëzojë të rinjtë për një jetë të shëndetshme e aktive.

Përmes angazhimeve të tilla, Fakulteti do të vazhdojë të kontribuojë në krijimin e një mjedisi sportiv gjithëpërfshirës dhe edukativ, duke përkrahur zhvillimin e vlerave të mirëfillta sportive në shoqëri.



ËSHTË SANUAR PROBLEMI I FURNIZIMIT ME UJË NË FEFS

Me mbështetjen e KRU Prishtina, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit ka sanuar problemin e furnizimit me ujë. Ky përmirësim i kapacitetit me furnizim me ujë është i një rëndësie të veçantë për studentët dhe stafin tonë, duke garantuar një mjedis më të pastër dhe të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve akademike dhe sportive.

Gjithashtu, menaxhmenti i fakultetit ka treguar angazhim të lartë në përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimin e kushteve optimale për të gjitha proceset akademike dhe stërvitore. Përmes një qasjeje proaktive, janë implementuar masa të tjera si mirëmbajtja e hapësirave sportive dhe investimi në pajisje të reja moderne për stërvitje, duke siguruar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e suksesshëm të studentëve tanë.



JANË REALIZUAR TAKIME TË RËNDËSISHME ME INSTITUCIONET RELEVANTE

FEFS ka zhvilluar takime të rëndësishme me institucione relevante, duke përfshirë Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komitetin Olimpik të Kosovës, përfaqësues të ambasadave dhe shumë organizata të tjera. Këto takime kanë pasur për qëllim krijimin e urave të bashkëpunimit dhe shkëmbimin e ideve për projekte dhe iniciativa që do të kontribuojnë në zhvillimin e sportit dhe edukimit fizik në vend. Angazhimi i përbashkët i këtyre institucioneve dhe fakultetit synon të nxisë rritjen e cilësisë në arsim, avancimin e hulumtimeve shkencore dhe promovimin e vlerave të sportit si mjet për zhvillim shoqëror dhe profesional.



PJESËMARRJA E MENAXHMENTIT TË FEFS, NË FORUMIN E 17-TË TË ENSE, MBAJTUR ME 01 DHE 02 NËNTOR 2024, NË TIRANË

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit bëhet anëtar edhe i një organizate prestigjioze siç është European Network of Sport Education (ENSE).

Menaxhmenti i FEFS-së mori pjesë në forumin e 17-të të ENSE i cili u mbajt me datë 01-02 nëntor në Tiranë. ENSE është një organizatë e cila ka për qëllim krijimin e mundësive për mësim, aftësi, kompetenca dhe kualifikime në të gjitha mjediset për njerëzit ose organizatat që udhëheqin, zhvillojnë dhe mbështesin aktivitetet sportive.

ENSE synon ta arrijë këtë duke punuar në projekte pan-evropiane, duke krijuar materiale inovative arsimore, duke lidhur organizatat që punojnë në fushën e edukimit sportiv dhe duke avokuar për politika efektive në nivel evropian.

Në këtë drejtim, fakulteti ynë luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm në fushën e edukimit fizik, sportit dhe shëndetit publik në Republikën e Kosovës.

Duke u bërë pjesë e një rrjeti ndërkombëtar si ENSE, ne mund të përfitojmë nga shkëmbimi i praktikave më të mira dhe nga rritja e bashkëpunimeve me institucione prestigjioze në të gjithë Evropën.

Përmes këtij anëtarësimi, do të kemi qasje në programe të avancuara, trajnime dhe burime të reja që do të përmirësojnë cilësinë e kurrikulave tona në edukimin fizik dhe sport. Studentët dhe stafi akademik do të përfitojnë nga mundësitë e shkëmbimeve ndërkombëtare dhe projekteve kërkimore të përbashkëta, duke zgjeruar përvojat dhe kapacitetet e tyre profesionale.

Gjithashtu, pjesëmarrja e FEFS-së në ENSE do të mundësojë kontributin në diskutimet evropiane mbi politikën sportive dhe edukimin fizik, duke sjellë zërin e Kosovës në skenën ndërkombëtare.

FEFS mbetet i përkushtuar në ofrimin e kushteve ideale për edukim, punë profesionale dhe bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar.



FEFS AKTIV EDHE NË FORUMIN E 6-TË NË “TRYEZA SPORTIVE”

Dekani i Fefs Prof.Asst.Dr.Florian Miftari dhe sekretari Dr.Gani Ibrahim, kanë marrë pjesë në platformën e 6-të “Tryeza Sportive” organizuar nga MKRS dhe KOK.

Në këtë tryezë u diskutua për zhvillimet e reja të Ligjit, nga të cilat përfiton i gjithë komuniteti sportiv në Republikën e Kosovës.

Disa nga temat që u trajtuan janë ndryshimet statutore të nevojshme për organizatat sportive, detyrat dhe përgjegjësitë e federatave, si dhe procedura e lejimit të veprimtarisë së tyre, statusi dhe regjistrimi i klubeve sportive, licencimi i trajnerëve, instruktorëve dhe agjentëve sportivë, kujdesi për sportistët, detyrimet kontraktuale ndaj sportistëve.

U diskutua gjithashtu për zhvillimin e sportit në të gjitha nivelet dhe garat ndërkombëtare, procedurat e regjistrimit të shkollave të sportit, qendrave të fitnesit dhe qendrave sportive, sistemi i ri i financimit të sportit, lidhja me performancën dhe transparencën e auditimit.



STUDENTET E FEFS MORËN PJESË NË KONFERENCËN E 7-TË “BARAZIA GJINORE DHE DIVERSITETI”

KOK-u përmes komisionit “Femra dhe Sporti” ka organizuar edicionin e 7-të të konferencës “Barazia Gjinore dhe Diversiteti”, e cila këtë herë u zhvillua me temën “Loja e barabartë – gratë në udhëheqje”.

Qëllimi i kësaj konference ishte të promovojë dhe nxisë rritjen dhe përfshirjen e vajzave dhe grave në sport, si dhe në fusha të ndryshme.

Konferenca u mbajt në Bibliotekën Kombëtare “Pjetër Bogdani”, në të cilën morën pjesë përfaqësues të shumtë të federatave sportive, MKRS, deputetë të Kuvendit të Kosovës, Komuna e Prishtinës, Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, studentë, etj.

Panelistët nga biznesi folën për shembujt e mirë që ka biznesi në lidhje me barazinë gjinore, praktika këto që mund të kontribuojnë edhe në sport, derisa komuniteti i sportit foli për rolin dhe fuqizimin e vajzave në sport.



TAKIM I RËNDËSISHËM NË MËS TRUPIT KËSHILLËDHËNËS, STAFIT AKADEMIK DHE PËRFAQSUESVE TË STUDENTËVE TË FEFS-IT

Në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, sot u mbajt një takim i rëndësishëm me Trupin Këshillëdhënës të Fakultetit, stafin akademik dhe përfaqësuesit e studentëve.

Takimi ishte jashtëzakonisht produktiv, duke u fokusuar në avancimin e interesave të studentëve dhe lidhjen e tyre me industrinë sportive dhe institucionet relevante.

Në takim ndër të tjera u theksua:

1. Zhvillimi i programeve të reja studimore – u diskutua mbi nevojën e përgatitjes së programeve që adresojnë kërkesat e industrisë dhe mundësojnë përgatitjen më të mirë të studentëve për tregun e punës. Sidomos në fushën e manxhimit dhe administrimit sportiv.
2. Projekte në edukimin dhe zhvillimin profesional të studentëve – u prezantuan ide dhe iniciativa që do të rrisin përfshirjen e studentëve në aktivitete praktike.
3. Vizita studimore dhe bashkëpunime – Trupi Këshillëdhënës dhe menaxhmenti i fakultetit u dakorduan për hapa konkret në organizimin e vizitave studimore në institucione dhe organizata si:

- Komiteti Olimpik i Kosovës,
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Federatat sportive,
- Klube sportive dhe organizata të tjera me ndikim në industrinë e sportit.

Takimi u pasurua nga pjesëmarrja e personaliteteve të rëndësishme si:

- Z. Blerand Stavileci, Kryetar i Trupit Këshillëdhënës të FEFS-it,
- Z. Ibër Alaj, Drejtor në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Z. Labinot Salihu, Drejtor i KUSAS,
- Z. Granit Rugova, Drejtor për Zhvillimin e Programeve në Federatën e Basketbollit të Kosovës.

Gjithashtu, në këtë takim morën pjesë menaxhmenti i FEFS-it, stafi akademik dhe studentët, duke kontribuar me diskutime të vlefshme dhe ide inovative për të ardhmen.

Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ndërmjet fakultetit, industrisë dhe institucioneve sportive, me synimin për të ofruar mundësi konkrete zhvillimi për studentët tanë.





PJESËMARRJA E FEFS NË KONFERENCËN “SPORTS AS VALUE” ORGANIZUAR NGA KOK-U

Menaxhmenti dhe studentët e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS) morën pjesë në konferencën përmbyllëse të projektit “Sports as Value”, e organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës. Ky projekt, i fokusuar në promovimin e sportit bazë si vlerë shoqërore, përfshiu hulumtime të thelluara për gjendjen aktuale dhe planifikimin strategjik të sportit bazë në vendet e rajonit.

FEFS luajti një rol kyç në këtë iniciativë, duke kontribuar me ekspertizë dhe analiza të rëndësishme shkencore, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e politikave sportive në rajon.

Fakulteti mbetet i përkushtuar të punojë edhe më shumë në këtë drejtim, duke përforcuar përpjekjet për avancimin e edukimit dhe sportit në Kosovë, si dhe përkrahjen e zhvillimit të sportit si mjet për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe promovimin e vlerave shoqërore.



STUDENTËT E FEFS-IT NGJESIN MAJËN E LUBOTENIT

Një grup studentësh nga Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, të apasionuar pas alpinizmit, organizuan me vetë-iniciativë ngjitjen e Majës së Lubotenit në kushte dimri, në një lartësi mbidetare prej 2498 metrash. Ky aktivitet u mbështet nga profesori Besim Halilaj.

Përballë temperaturave nën zero, terrenit sfidues dhe erërave të forta, grupi i studentëve arriti me sukses të ngjitej në majë, duke përdorur pajisje ndihmëse dhe nën udhëheqjen e profesionistëve të ngjitjes. Gjatë kësaj aventure sfiduese, ekipi përjetoj një eksperiencë të jashtëzakonshme, duke vepruar me frymën e bashkëpunimit: "Të gjithë për një, një për të gjithë."

Shijoni pamjet nga kjo ekspeditë e suksesshme e ngjitjes së Lubotenit.

Studentët e FEFS, 24 nëntor 2024.



PËRGATITJET E FUNDIT PËR VENDOSJEN E INSTITUTIT NË SHËRBIM

Studentë të dashur, staf akademik, trajnerë dhe ekspertë të shkencave sportive, komunitet sportiv, sportistë, organizata sportive dhe entuziastë të shëndetit dhe mirëqenies, bëhuni gati për një kapitull të ri në Institutin e Shkencave të Sportit, në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit!

Nga shkenca në praktikë, drejt ekselencës - Instituti ynë po ndërtohet si një urë e fuqishme mes dijes dhe veprimit për të nxitur avancimin tuaj akademik, profesional dhe shoqëror. Duke bashkuar studentët, stafin akademik, ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, sportistët, organizatat sportive, industrinë dhe komunitetin e gjerë, qëllimi ynë është të krijojmë një platformë që jo vetëm fuqizon edukimin dhe trajnimin, por edhe promovon dijen, inovacionin dhe kërkimet shkencore në sport dhe mirëqenie.

Me pajisje moderne, ekspertizë dhe programe të avancuara, Instituti do të jetë një hapësirë ku pasioni për sportin takon shkencën dhe praktikat më të mira, duke kontribuar në zhvillimin e komunitetit dhe arritjet personale.

Dicka e mahnitshme po ju pret - qëndroni gati për një udhëtim drejt së ardhmes së shkëlqyer!



PJESËMARRJA E PRODEKANËVE NË FORUMIN “BEACTIVE”

Prodekanët Prof. Ass. Malsor Gjonbalaj dhe Faton Tishukaj morën pjesë në forumin #BeActive të organizuar nga MKRS. Ky forum promovoi rëndësinë e aktivitetit fizik dhe jetës së shëndetshme, duke përfshirë aktorë kryesorë nga fusha e edukimit dhe sportit. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS) prezantoi projektin SHAPE, ku është partner në një konsorcium me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në kuadër të platformës #BeActive dhe asaj të Balkan Week of Sport, FEFS organizoi aktivitete të ndryshme që synojnë promovimin e stilit të jetesës aktive dhe përfshirjen e komunitetit. Gjatë forumit u theksua rëndësia e bashkëpunimit të deritanishëm ndërmjet institucioneve dhe u diskutuan ide për forcimin e kohezionit në të ardhmen, si dhe realizimin e projekteve që kontribuojnë në shoqëri më të shëndetshme dhe aktive.



VAZHDOJNË HULUMTIMET E FEFS

STATUSI I RITJES DHE ZHVILLIMIT TË FËMIJËVE TË CIKLIT TË ULËT FILLORË NË SHSTATË REGJIONET E KOSOVËS
Dr.Hasim Rushiti, Prof. Asst. Dr. Besim Halilaj, Prof.Asst Ilir Gllareva
Dr.Bujar Turjaka, Prof.Asst Besnik Morina, MA. Ard Kryeziu

QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të vërtetohet statusi aktual i rritjes dhe zhvillimit fizik të fëmijëve duke përfshirë matjet e karakteristikave bazike antropometrike dhe bazës së përgjithshme lëvizore të nxënësve të ciklit të ulët fillor ku përfshihen nxënësit nga klasa parë deri në klasën e pestë përkatësisht moshë 6 deri 10 vjeç prej dy gjinive, në zonat urbane dhe rurale, si dhe krahasimi i tyre me standardet e rritjes së fëmijëve sipas standardeve të Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), dhe disa testeve nga Youth Fitness Test Norms (YFTN).

MOSTRA E TË HULUMTUARËVE

Në këtë studim janë përfshirë rreth 3000 nxënës, vajza dhe djem të cilët ndjekin mësimin në ciklin e ulët të moshës 6 deri 10 vjeç përkatësisht nga klasa e parë deri në klasën e pestë në Shkollat Filllore të Ulëta në shtatë regjionet e Republikës së Kosovës. Nga të dhënat statistikore zyrtare të MASHT-it të vitit 2022-23 Numri i nxënësve në arsimin fillor janë 118,943 nxënës prej tyre 57,752 femra dhe 61,191 meshkuj, për më shumë, kliko [këtu](#).

Kjo do të thotë se janë nevojitur më shumë se 1071 nxënës në nivel të besueshmërisë prej 99.9% e ku vlera reale është brenda $\pm 5\%$ e vlerës së testimit.

bashkëngjitur gjeni disa nga matjet në teren të cilat janë realizuar nga profesorët dhe studentët e FEFS në periudhën Mars - Qershor 2024.



KA FILLUAR PUNËN PROJEKTI I RI NË KRYE ME PROF.ASST. BESNIK MORINA

DALLIMET NË PËRHAPJEN E MIPESHËS DHE OBEZITETIT SI DHE NIVELIT TË AFTËSIVE MOTORIKE TE NXËNËSIT E SHKOLLAVE FILLORE, TË ZONAVE URBANE DHE RURALE TË REPOBLIKËS SË KOSOVËS”

Qëllimi i projektit është të përcaktojmë nëse ka një ndryshim statistikor të rëndësishëm në përhapjen e mbipeshës dhe obezitetit si dhe të nivelit të aftësive motorike të nxënësve të shkollave fillore, moshë 7-11 vjeçare në lidhje me moshën dhe gjininë të zonave urbane dhe rurale të Kosovës.



WORKSHOP ME MKRS

Në vazhden e bashkëpunimit mes FEFS dhe MKRS, është mbajtur takimi i parë i grupeve punuese, me qëllim vendosjen e pikave të përbashkëta për një bashkëpunim zyrtar për vitet e ardhshme. Bashkëpunimi synon thellimin dhe zyrtarizimin me një memorandum bashkëpunimi, si dhe përcaktimin e formave dhe veprimeve të përbashkëta në dobi të zhvillimit të edukimit fizik dhe sportit, si dhe ruajtjes së shëndetit dhe mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve të vendit tonë.




STUDENTET E FEFS MË TË MIRËT NDËR VITE NË GARA NDËRKOMBËTARE, TRADITA VAZHDON



Për më shumë informata, ju lutem kontaktoni :

 fefs@uni-pr.edu

 +383 38 243 747



Copyright (C) 2024 Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit
Universiteti i Prishtinës